

BËHU SHFRYTËZUES

I AFTË I INTERNETIT!

MBAJI MEND KËTO 5 RREGULLA QË TË MUND TA SHFRYTËZOSH INTERNETIN DHE TELEFONIN CELULAR NË MËNYRË TË AFTË DHE TË SIGURT. LEXO PSE JANË TË RËNDËSISHME.



Lexo pse është me rëndësi të jesh i kujdesshëm derisa luan lojëra në kompjuter, dëgjon muzikë, zbulon informata të reja, "shkarkon" përmbajtje (muzikë, filma, video klipe etj), respektivisht korrespondon me persona të tjerë në internet apo nëpërmjet telefonit tënd celular...



I SIGURT

Kujdes me internetin! Mos ua jep njerëzve me të cilët bisedon në internet (*MSN Messenger, Skype, ICQ, Yahoo! Messenger, e-mail* ose nëpërmjet kanaleve të tjera për komunikim në internet) të dhënat tua personale, siç janë emri dhe mbiemri, adresa e e-mailit, numri i telefonit, adresa e shtëpisë, fotografi ose emri i shkollës në të cilën mëson.



PSE?

Ruaji të dhënat tua personale kur je online sepse asnjëherë nuk mund të jesh i sigurt se ku do të përfundojnë ata, për çka do të shfrytëzohen dhe kush mund të të gjejë me ndihmën e tyre. Mbjaj mend se kur dërgon diçka nëpërmjet telefonit tënd celular ose në internet, përmbajtja që e dërgon shumë lehtë mund të kopjohet ose ndryshohet dhe si e tillë të mbetet përgjithmonë në internet.

TAKIMI KOKË MË KOKË



Takimi kokë më kokë me dikë që e njeh vetëm nëpërmjet internetit mund të jetë i rrezikshëm. Bëje këtë vetëm me lejen e prindërve ose të kujdestarit, por edhe atëherë - vetëm me prezencën e tyre.

PSE?

Asnjëherë mos ndjej obligim se duhet ta njoftosh dikë që e njeh vetëm nëpërmjet internetit. Disa njerëz mund të mos jenë ashtu siç tregohen në internet. Është vështirë të kuptohet se personin që e njeh vetëm nëpërmjet internetit dhe me të cilin bisedon rregullisht, në realitet nuk e ke shok të ngushtë. Normalisht, duke biseduar me të për një kohë të gjatë fillon ta ndjesh si të afërm. Prandaj, nëse me të vërtetë dëshiron ta njohësh personalisht - patjetër shko me njërin prej prindërve ose kujdestarin. Për çdo rast - takohuni në vend publik dhe ditën.

Lexo disa ngjarje të vërteta për atë se si disa njerëz janë lënduar kur kanë vendosur të takohen "live" me online shokët:

www.internetisigurt.org.mk/pervoja

PRANIMI I PËRMBAJTJEVE

Pranimi i e-mailit, instant-porositave ose hapja e dosjeve, fotografive ose teksteve të pranuar nëpërmjet internetit nga persona të cilët nuk i njeh ose të cilëve nuk mund t'u besosh, mund të shkaktojnë probleme - ato mund të përmbajnë viruse ose përmbajtje të padëshirueshme të cilat mund të shqetësojnë.



PSE?

Nëse e hap "shkarkon" (ang.: *download*) ose pranon përmbajtje apo e-maila prej njerëzve të cilët nuk i njeh, mund ta rrezikosh sigurinë tënde ose sigurinë e kompjuterit tënd. Gjithmonë shlyej porositë ose e-mailat që i merr nga njerëz të panjohur, blloko dërguesit e reklamave që nuk i kërkon (*junk, spam*) ose porositë e pahijshme dhe në kompjuterin tënd instalo softuer antivirus.

VËRTETËSIA E INFORMATAVE



Informatat që i gjen në internet mund të mos jenë të vërteta. Jo gjithçka që është në internet është e saktë apo e vërtetë. Gjithashtu, disa njerëz me të cilët komunikon nëpërmjet internetit, mund të gënjejnë në lidhje me atë se kush janë dhe të prezantohen ndryshe.



PSE?

Nuk mund t'u besohet të gjitha ueb-faqeve ose të gjithë njerëzve, sepse në internet secili ka liri të shkruajë çka të dojë! Gjithmonë krahaso informatat që i gjen online me informata nga ueb-faqe të tjera, libra apo njerëz të cilët kanë njohuri, që të jesh i sigurt se janë të sakta. Mëso si t'i bllokosh njerëzit me të cilët bisedon në internet për të cilët mendon se të gënjejnë. Në këtë ueb-faqe mund të lexosh se si të dallosh cilave ueb-faqe mund t'u besosh e cilave jo:

www.internetisigurt.org.mk/besim

FOL PËR PËRVOJAT NË INTERNET

Përderisa dikush ose diçka në internet të bën të mos ndjehesh mirë, të brengos apo në ndonjë mënyrë të shqetëson, menjëherë tregoju prindërve, kujdestarëve apo ndonjë personi tjetër të rritur te i cili ke besim.



PSE?

Ndonjëherë njerëzit në internet bëjnë apo thonë gjëra që nuk janë të vërteta ose shtiren se janë dikush që s'janë. Më tej, shumë lehtë mund të qasesh në një numër të madh ueb-faqesh të pahijshme dhe të papëlqyeshme, rastësisht apo me qëllim. Nëse disa nga këto gjëra të brengosin, asnjëherë s'është vonë të bisedosh për këtë me ndonjë të rritur të cilit i beson. Ai do të ndihmojë. Mund të bisedosh me prindin, kujdestarin, arsimtarin, të lajmërohesh në SOS-telefonin për fëmijë dhe të rinj (080012222) ose t'i drejtohesh policisë (192).